metodologjinë. Trajnuesit dhe trajnerët kryesorë më pas trajnuan kandidatët për kontrollorë (në fund të Gushtit) dhe kandidatët për anketues (në fillim të Shtatorit), ku në këto trajnime mbikëqyrësit e përzgjedhur asistuan trajnerët. Në muajin Gusht, u trajnuan nga specialistët e INSTAT, sipas fushave përkatëse gjithashtu, punonjësit mbështetës të GIS dhe punonjësit mbështetës të TI.

Periudha gjashtë-javore e numërimit në terren në 568 ZC filloi mesnatën e Censit, 17 - 18 Shtator 2023, e mbështetur dhe e mbikëqyruar nga 113 kontrollorë, 17 mbikëqyrës, 10 staf mbështetës të GIS dhe 20 staf mbështetës të TI. Censi u monitorua më tej përmes platformës së monitorimit dhe vizitave në terren nga stafi i INSTAT qendër dhe zyra rajonale. Periudha e mbledhjes së të dhënave u zgjat me dy javë deri më 15 Nëntor, për të numëruar NjEF që nuk mund të kontaktoheshin në periudhën e caktuar të Censit dhe për të përfunduar punën në terren në zonat që përmbanin më shumë njësi Censi sesa pritej për shkak të ndërtimeve të reja ose lëvizjeve të popullsisë si pasojë e tërmetit. Kjo u pasua nga dy javë të tjera aktivitete verifikimi në terren nga punonjësit e INSTAT. Aktiviteti i fundit në terren ishte APC për një periudhë katër javore në Dhjetor 2023. Periudha e pas-numërimit deri në muajin Qershor 2024 iu dedikua plotësisht aktiviteteve të përpunimit të të dhënave, duke përfshirë editimin, imputimin dhe ndërtimin e variablave të derivuar. Në periudhën Korrik - Tetor 2024, u prodhuan grupi i tabelave të Censit të detajuara në nivel qarku, bashkie dhe njësie administrative dhe iu nënshtruan procedurave të vlerësimit.

Gjithashtu, filluan aktivitetet për përgatitjen e një baze zgjedhjeje të përditësuar për anketat pranë familjeve, bazuar në rezultatet e Censit. Raporti kryesor i Censit me grupin e parë të tabelave u përgatit në Qershor dhe u shpërnda më 28 Qershor në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në Planin Vjetor dhe Kalendarin e Publikimeve të INSTAT.

1.5 Pyetësi i Censit

Pyetësi i Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 në Shqipëri është rezultat i një procesi të gjatë konsultimesh me palët e interesuara, rishikimit të rekomandimeve ndërkombëtare për Censet, si dhe një seminari të dedikuar me ekspertë kombëtarë

trainings the selected supervisors assisted the trainers. In August, also GIS support staff and IT support staff were trained by INSTAT specialists in the respective fields.

The six-week enumeration period in 568 EAs started on the census night from 17 to 18 September 2023, supported and supervised by 113 controllers, 17 supervisors, 10 GIS support staff and 20 IT support staff. The enumeration was furthermore monitored with the Census monitoring tool and with field visits by INSTAT regional and headquarters staff. The data-collection period was extended by two weeks to 15 November, to follow up on households that could not be contacted in the designated enumeration period and complete the fieldwork in areas that contained more Census units than expected due to new constructions or population movements because of the earthquake. This was followed by another two weeks of field-validation activities by INSTAT staff. The last field activity was the four-week PES in December 2023. The post-enumeration period until June 2024 was fully dedicated to data-processing activities, including editing, imputation and construction of derived variables. In July and October 2024, the group of Census tables detailed at the prefecture, municipality and administrative unit level were produced and subjected to validation procedures.

In addition, activities started to prepare an updated sampling frame for household surveys, based on the Census results. The main Census report with the first set of tables was produced in June and disseminated on 28 June in accordance with the timeline defined by INSTAT.

1.5 Census questionnaire

The questionnaire of the Albania Population and Housing Census 2023 is the result of a lengthy process of consultations with stakeholders, review of international Census recommendations and a dedicated workshop with national and international Census experts. The questionnaire fully complies with the recommendations of the Conference of European Statisticians on the inclusion of core topics and incorporated several topics addressing the specific information needs for INSTAT and Albania. In addition, the questionnaire design was updated to take full advantage

dhe ndërkombëtarë të fushës. Pyetësi përputhet plotësisht me rekomandimet e Konferencës së Statisticienëve Evropianë për përfshirjen e temave thelbësore dhe ka përfshirë disa tema që adresojnë nevojat specifike të informacionit për INSTAT dhe Shqipërinë. Për më tepër, hartimi i pyetësit u përditësua për të përfituar plotësisht nga mundësitë e ofruara, si dhe duke adresuar kufizimet e mundshme, si pasojë e intervistimit përmes tabletave.

Moduli i parë nga 11 modulet e pyetësit u hartua për të identifikuar ndërtesat në të cilat duhet të numërohen njësitë statistikore të Censit dhe për të mbledhur karakteristikat e ndërtesave, të nevojshme për zhvillimin e regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave. Dy module u krijuan për mbledhjen e informacionit mbi banesat, duke përfshirë temat thelbësore të Censit, si dhe informacionin mbi adresën, për zhvillimin e regjistrit statistikor të banesave. Dy module të tjera mbuluan informacione rreth karakteristikave të njësive ekonomike familjare: një mbi statusin e pronësisë dhe kushtet e banimit në NJEF për ndërtimin e një indeksi të mirëqënies dhe një tjetër mbi aktivitetet bujqësore për ndërtimin e kornizës së njësive ekonomike bujqësore për Censin e Bujqësisë. Dy module u përfshinë për të mbledhur informacion mbi anëtarë, vendbanues të zakonshëm të NJEF: një listë për NJEF dhe një modul me pyetje të hollësishme individuale. Këto module përfshinin tema kryesore të Censit, si dhe informacion shtesë mbi, ndër të tjera, migrimin e brendshëm dhe ndërkombëtar, shkrim-leximin, ndjekjen e shkollës, vendin e punës, mënyrën dhe kohën e udhëtimit për në punë, fëmijët e lindur ndonjëherë, aftësinë e kufizuar dhe informacionin mbi karakteristikat etno-kulturore, (etnia, feja, gjuha që flitet në shtëpi). U përfshinë module të veçanta për të renditur vizitorët dhe ish-anëtarët e NJEF që jetojnë jashtë vendit, së bashku me karakteristikat e tyre bazë. U zhvillua një pyetësor i veçantë për numërimin e banesave kolektive dhe anëtarëve të NJEF kolektive që jetonin në to. Ky ishte një version i shkurtuar i pyetësit për NJEF private. Paralelisht, u zhvillua një pyetësor për APC, i cili përmbante pyetje për identifikimin e njësive statistikore të Censit, si edhe pyetje që mundësonin të dhëna mbi përputhjen e të dhënave, analizën e mbulimit, si dhe analizën e gabimeve në përmbajtje. Krahasuar me pyetësin e Censit të vitit 2011, versioni i vitit 2023 ishte më i gjatë. Më shumë informacion u mblodh veçanërisht në lidhje me karakteristikat e ndërtesës në modulin e identifikimit të ndërtesës, aktivitetet

of the opportunities provided by computer-assisted interviewing and to address its limitations.

The first of 11 questionnaire modules were designed to identify buildings in which Census units need to be enumerated and collect building characteristics required for the development of a statistical register of buildings and dwellings. Two modules were designed for collecting information on dwellings, including Census core topics, as well as address information for the development of a statistical dwelling register. Another two modules covered information about household characteristics: one on tenure status and household amenities for the construction of a wealth index, and another on agricultural activities for the construction of a frame of agricultural holdings for the Agricultural Census that will follow the Population and Housing Census. Two modules were included to capture information about usual household members: a household roster and a module with detailed individual questions. These modules included Census core topics, as well as additional information on, among others, internal and international migration, literacy, school attendance, place of work, mode and time of travel to work, children ever-born, disability and ethno-cultural information (ethnicity, religion, language spoken at home). Separate modules were included to list visitors and former household member living abroad, together with their basic characteristics. A separate questionnaire was developed for the enumeration of collective living quarters and members of collective households living there. This was a strongly abbreviated version of the questionnaire for private households. In parallel, a PES questionnaire was developed, containing questions for identification of Census units and questions providing data for record matching and coverage analysis, as well as for content-error analysis. Compared to the 2011 Census questionnaire, the 2023 version was considerably longer. More information was particularly obtained about building characteristics in the Building identification module, agricultural activities in the separate Agricultural module, dwelling address in the Dwelling module, and family relations and commuting to work in the Individual module.

bujqësore në modulin e veçantë për bujqësinë, adresën e banesës në modulin e banesës dhe lidhjen në bërthamën familjare dhe vajtje-ardhjen për në punë në modulin individual.

1.6 Gjeografia e Censit dhe aktivitetet gjeohapësinore

Roli i sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) në Censin e Popullsisë dhe Banesave është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm. Këto sisteme siguruan bazën për ndërtimin e gjeodatabazës së Censit që përfshin informacionin gjeohapësinor për të gjitha ndërtesat, hyrjet dhe banesat në Shqipëri. Informacioni fillestar u mbledh gjatë përditësimit në terren në shkallë vendi përpara fillimit të Censit. Përditësimi u krye në vitin 2019, por për shkak të shtyrjes së Censit në vitin 2023 dhe tërmetit të vitit 2019, baza gjeografike e Censit kërkoi një rifreskim. Një përditësim i ri i plotë ishte i pamundur, ndaj ushtrimi u përsërit vetëm në zonat e prekura nga tërmeti dhe në zona të tjera me intensitet të lartë ndërtimesh. Gjeodatabaza e Censit do të përditësohet më tej me informacionin mbi ndërtesat dhe banesat e ardhura nga terreni dhe do të përbëjë bazën për ndërtimin e Regjistrat Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave në Shqipëri. Baza e të dhënave gjeografike para fazës së numërimit u përdor për të përcaktuar kufijtë e Zonave të Censit (ZC) me një madhësi mesatare prej rreth 200 banesa për ZC. Ky është afërsisht dyfishi i numrit të banesave për ZC në krahasim me Censin e vitit 2011. Zmadhimi i zonave të Censit çoi në uljen e konsiderueshme të kostos për tabletat, që u përdorën në Censin e vitit 2023. Madhësia e Zonave të Censit ishte gjithashtu arsyeja për të planifikuar një periudhë numërimi prej gjashtë javësh në terren, krahasuar me tre javë në vitin 2011. Një aktivitet kryesor pas përfundimit të Censit është ndarja e ZC në zona më të vogla që do të përdoren si bazë zgjedhjeje për vërtetimet e ndryshme që INSTAT realizon. Një nga risitë kryesore të Censit 2023 ishte përdorimi i hartave digjitale interaktive të zonave të Censit, që tregonin kufijtë e ZC, vendndodhjen e ndërtesave dhe të hyrjeve. Hartat digjitale u integruan në aplikacionin e Censit CAPI, gjë që iu mundësoi anketuesve të shihnin ecurinë e numërimit të ndërtesave dhe banesave në zonën e tyre të Censit, si dhe detaje të tjera të banesave të numëruara. Këto harta gjithashtu i mundësuan anketuesve vizualizimin dhe orientimin në zonat e Censit me saktësi më të madhe, duke siguruar mbulim gjithëpërfshirës dhe reduktim të probabilitetit

1.6 Census mapping and geospatial activities

The role of GIS activities in the Census has become increasingly important. They provided the basis for the construction of the Census geodatabase that include geo-referenced information about all buildings, dwellings and building entrances in Albania. Initial information was collected in a country-wide mapping exercise prior to the Census. This exercise was completed in 2019, but became outdated due to the earthquake in November of that year and the postponement of the enumeration to 2023. Although a full update of the exercise has been impossible, in areas affected by the earthquake and subsequent displacement and in areas with high building activity, mapping activities were repeated. The Census geodatabase will be updated with information about buildings and dwellings and will provide the basis for a statistical register on buildings and dwellings in Albania. The pre-Census database was used to delineate the Census EAs comprising, on average, an estimated number of around 200 dwellings per area. This is about two times the number of dwellings per EA in the 2011 Census, which allowed a major cost reduction for the tablets that were used in the 2023 Census. The larger size of EAs was also the reason to plan an enumeration period of six weeks, compared to three weeks in 2011. A main post-enumeration activity is the division of Census EAs into smaller areas that can be used as sampling frame for household surveys. One of the main innovative features of the 2023 Census was the use of interactive digital enumeration area maps, showing the EA boundaries and the locations of buildings and building entrances in the area plotted on satellite imagery. The digital maps were integrated in the Census CAPI application, which allowed enumerators to see the enumeration status of the buildings and dwellings in their EA, as well as other details of the enumerated dwellings. These maps also enabled enumerators to visualise and navigate Census EAs with greater precision, ensuring comprehensive coverage and reducing the likelihood of missed dwellings and households. The integration of EA maps and the digital version of the Census questionnaire also provided the basis for an innovative Census monitoring tool. This consisted of a dashboard with a set of indicators about the progress and quality of the enumeration at enumerator-, controller-, supervisor- and municipality level. Given daily data transmission from the field, the dashboard provided almost real-time infor-

të mos numërimit të ndërtesave, banesave dhe njësive ekonomike familjare. Integrimi i hartave në aplikacionin e mbledhjes së të dhënave dhe versioni digjital i pyetësorit të Censit siguroi gjithashtu bazën për një sistem inovativ të monitorimit të tij. Ky sistem përbëhej nga një panel me një grup treguesish për ecurinë dhe cilësinë e numërimit në nivel anketuesi, kontrollori, mbikëqyrësi dhe nivel bashkie. Duke pasur parasysh transmetimin ditor të të dhënave nga terreni, sistemi i monitorimit ofroi informacion pothuajse në kohë reale për situatën në terren duke mundësuar ndërhyrjen e menjëhershme nëse shfaqeshin problematika.

1.7 Përdorimi i teknologjisë së informacionit

Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023, shënoi një përparim të madh lidhur me aplikimin e teknologjisë së informacionit (TI) në operacionet e statistikave zyrtare në vend. Tradicionalisht i kryer përmes pyetësorëve në letër dhe vizitave derë më derë, ky Cens solli një transformim digjital gjithëpërfshirës duke përdorur pyetësorët elektronikë të administruar përmes tabletave. Zbatimi i metodës të Intervistimit Personal të Asistuar nga Kompjuteri (CAPI) mundësoi një proces më efikas dhe më të saktë të mbledhjes së të dhënave, duke reduktuar ndjeshëm gabimet që zakonisht lidhen me hedhjen manuale të të dhënave. Kjo qasje digjitale u mbështet më tej nga një platformë e fuqishme për mbledhjen e të dhënave e zhvilluar duke përdorur Sistemin e Përpunimit të Censit dhe Anketave (CSPRO), një softuer me domëin publik i zhvilluar nga Byroja e Censit të Shteteve të Bashkuara. Në qendër të këtij transformimi digjital ishte krijimi i pyetësorëve elektronikë që mundësonin kontrollin e përgjigjeve në kohë reale. Ky mekanizëm kontrolli ishte thelbësor për të siguruar integritet më të lartë të të dhënave, duke identifikuar dhe korrigjuar menjëherë mospërputhjet ose gabimet gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave. Rrjedhimisht, cilësia dhe besueshmëria e të dhënave të Censit u rritën dukshëm. Një tjetër avantazh i rëndësishëm i pyetësorëve elektronikë është eliminimi i gabimeve në rrjedhën logjike të pyetësorëve, të cilët janë veçanërisht të rëndësishme në një Cens ku pyetësi shpesh përfshin rrjedhë logjike komplekse. Rrjedha logjike e automatizuar siguron që anketuesit dhe të anketuarit të drejtohen pa probleme përmes pyetësorit, duke përshtatur në mënyrë dinamike rrjedhën e pyetjeve bazuar në përgjigjet e mëparshme. Kjo jo vetëm parandalon kapërcimin

information about the situation on the ground and enabled immediate intervention if issues were detected.

1.7 Use of information technology in the Census

The Albania Population and Housing Census 2023 marked a major advancement in the application of information technology (IT) in official statistical operations in the country. Traditionally conducted through paper questionnaires and door-to-door visits, this Census introduced a comprehensive digital transformation by utilising electronic questionnaires administered via tablets. Implementing Computer-Assisted Personal Interviewing (CAPI) facilitated a more efficient and accurate data collection process, significantly reducing the errors typically associated with manual data entry. This digital approach was further supported by a robust data collection platform developed using the Census and Survey Processing System (CSPRO), a public-domain software developed by the US Bureau of the Census. Central to this digital transition was the deployment of electronic questionnaires that featured on-the-fly validation of responses. This real-time validation mechanism was crucial in ensuring higher data integrity by promptly identifying and rectifying inconsistencies or errors during the data collection phase. Consequently, the quality and reliability of the Census data were markedly enhanced. Another significant advantage of digital questionnaires is the elimination of routing errors, which is particularly important in a Census where the questionnaire often includes complex routing. Automated routing ensures that enumerators and respondents are seamlessly guided through the questionnaire, dynamically adjusting the flow of questions based on previous answers. This not only prevents skipping necessary questions or answering irrelevant ones, but also reduces the burden on enumerators and respondents, allowing them to focus on accurately answering questions and recording responses. Overall, this functionality contributed to a more streamlined data collection process and further enhanced the accuracy and completeness of the collected data. Beyond enhancing data accuracy, the IT solutions implemented in the 2023 Census also incorporated robust mechanisms for timely problem resolution. The Issue Manager application played a critical role in this aspect by enabling team members from IT, GIS, Logistics, and HR across the country to report issues encountered during the

e pyetjeve të rëndësishme apo kryerjen e pyetjeve të panevojshme, por gjithashtu redukton barrën e të anketuarve dhe të anketuesve, duke i lejuar ata të fokusohen në përgjigjen e saktë të pyetjeve dhe regjistrimin e përgjigjeve. Në përgjithësi, ky funksion kontribuon në një proces më të efektshëm të mbledhjes së të dhënave dhe rrit më tej saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të mbledhura. Përtej rritjes së saktësisë së të dhënave, zgjidhjet e TI të zbatuara në Censin e vitit 2023 përfshinin gjithashtu mekanizma të fuqishëm për zgjidhjen në kohë të problematikave. Aplikacioni për Menaxhimin e Problematikave (Issue Manager) luajti një rol kritik në këtë aspekt duke u mundësuar anëtarëve të ekipeve të Teknologjisë së Informacionit, Hartografisë, Logjistikës dhe Burimeve Njerëzore, në të gjithë vendin të raportojnë problematikat e hasura gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave. Anëtarët e këtyre ekipeve, duke punuar në ambiente pune të ndryshme dhe shpesh të largëta, ishin në gjendje të raportojnë problematikat e tyre drejtpërdrejt në sistemin e Menaxhimit të Problematikave. Aplikacioni lehtësonte raportimin e detajuar të problematikave, kategorizimin e tyre sipas urgjencës dhe llojit, si dhe kanalizimin e tyre në njësitë përkatëse pranë zyrave qendrore të INSTAT. Kjo zgjidhje e qendërzuar siguroi që çdo çështje të trajtohej nga ekspertët më të përgatitur, pavarësisht nëse kërkohej mbështetje teknike e TI, përditësime të hartave digjitale, mbështetje logjistike apo ndërhyrje nga ana e burimeve njerëzore. Sistemi gjurmoi gjithashtu progresin e çdo problematike të raportuar, duke ofruar përditësime të statusit për anëtarët e ekipit raportues dhe duke siguruar një proces transparent dhe efikas të zgjidhjeve të tyre. Kjo qasje sistematike siguroi zgjidhje efektive dhe në kohë, duke minimizuar ndërprerjet në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe duke rritur efikasitetin e përgjithshëm operacional. Sinkronizimi ditor i të dhënave ishte një tjetër komponent kritik i zgjidhjeve të TI të përdorura në Cens. Ky proces siguroi që të dhënat e mbledhura nga anketuesit, duke përdorur pyetësorët elektronikë, të transmetoheshin rregullisht dhe në mënyrë të sigurt në serverët qendrorë. Çdo ditë, anketuesit sinkronizonin tabletat e tyre me sistemin qendror, duke ngarkuar të dhënat më të fundit të mbledhura dhe duke shkarkuar çdo përditësim të nevojshëm të aplikacionit të Censit. Ky sinkronizim rutinë minimizoi humbjen e të dhënave dhe lehtësoi kontrollin e vazhdueshme të cilësisë së të dhënave dhe integritetin në kohë të të dhënave të reja në bazën qendrore të të dhënave. Procesi i sinkronizimit ditor jo vetëm që rriti efikasitetin dhe saktësinë e mbledhjes së të dhënave, por gjithashtu

data collection phase. These team members, working in diverse and often remote locations, were able to log their problems directly into the Issue Manager system. The application facilitated detailed reporting of issues, categorising them based on urgency and type, and routing them to the appropriate units at INSTAT headquarters. This centralised handling ensured that each issue was addressed by the most relevant experts, whether it required technical IT support, GIS mapping corrections, logistical adjustments or human resources interventions. The system also tracked the progress of each reported issue, providing status updates to the reporting team members and ensuring a transparent and efficient resolution process. This systematic approach ensured timely and effective resolution of problems, minimising disruptions in the data collection process and enhancing overall operational efficiency. Daily data synchronisation was another critical component of the IT solutions implemented in the Census. This process ensured that data collected by enumerators using electronic questionnaires was regularly and securely transmitted to central servers. Each day, enumerators synchronised their tablets with the central system, uploading the latest collected data and downloading any necessary updates of the Census application. This routine synchronisation minimised data loss and facilitated continuous data quality checks and timely integration of new data into the central database. The daily synchronisation process not only enhanced the efficiency and accuracy of data collection but also ensured that INSTAT headquarters had up-to-date information for analysis and decision-making throughout the Census period.

1.8 Census communication and publicity

An important element in the success of a Census is awareness of and collaboration with the general public and specific target groups. To achieve these ends, INSTAT, together with national and international experts, developed an elaborate communication strategy, the implementation of which was largely outsourced to a communication agency.

The communication and outreach campaign covered the entire media landscape, including TV, radio, and social media across the country and interest groups. Publicity materials, including billboards, street posters, LED screens, videos and

siguroi që INSTAT të kishte informacion të përditësuar për analizë dhe vendimmarrje gjatë gjithë periudhës së Censit.

1.8 Komunikimi dhe publiciteti i Censit

Një element i rëndësishëm në suksesin e një Censi është ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me publikun e gjerë dhe grupet specifike të synuara. Për të arritur këto qëllime, INSTAT, së bashku me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, hartuan një strategji të detajuar komunikimi, zbatimi i së cilës u realizua kryesisht përmes një agjencie komunikimi. Fushata e komunikimit dhe informimit mbuloi të gjithë peizazhin mediatik, duke përfshirë TV, radio, media sociale në të gjithë vendin dhe grupet e interesit. Materialet publicitare, shumica e të cilave përfshinin mesazhet kryesore të Censit: “Unë, Ti, Ne” dhe “Mbaj të ardhmen në duart tua!”, u shpërndanë duke përfshirë: tabela në rrugë, postera, ekrane LED, video dhe pyetjet më të shpeshta (FAQ).

Duke pasur parasysh sfidën për të rekrutuar mijëra punonjës të përkohshëm për punën e Censit në terren, një pjesë e rëndësishme e fushatës së komunikimit iu kushtua ndërgjegjësimit për mundësitë e punësimit në aktivitetin e Censit.

1.9 Konfidencialiteti dhe siguria e të dhënave

Ligji për Statistikat Zyrtare, për Censin e Popullsisë dhe Banesave dhe për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcaktuan rregullat për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave në Cens. Ligjet parashikojnë që të dhënat e mbledhura nga Censi përdoren vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me standardet dhe rekomandimet e Eurostat dhe UNECE. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale kryhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, veçanërisht të drejtën për privatësi. Sipas këtyre ligjeve, rezultatet e shpërndara të Censit nuk mund t’i referohen individëve të veçantë dhe nuk duhet të përmbajnë identifikues personale ose informacione që mund të çojnë në identifikimin e individëve. Konfidencialiteti i të dhënave nuk kërkohet vetëm për shpërndarjen e rezultateve të Censit, por gjatë gjithë fazave të tij: nga mbledhja fillestare e të

Cens po ndodh në Fier

Merr pjesë në **Cens**, për një
të ardhme të informuar.

Për më shumë informacion telefononi në numrin e
gjelbër **0800 2244** ose vizitoni faqen:

instat.gov.al



Figura: Poster i Censit
Figure: Census Poster

dhënave deri te transferimi, përpunimi i të dhënave, analiza, tabelimi, shpërndarja dhe ruajtja. INSTAT zbatoi një sërë rregullash dhe procedurash gjithëpërfshirëse për të garantuar që në asnjë fazë të mos cënohet konfidencialiteti i të dhënave dhe që të dhënat të mbrohen në çdo kohë nga akses i personave të paautorizuar. Këto përfshinin, ndër të tjera, trajnimin e plotë të personelit të Censit mbi rëndësinë e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave, detyrimin ligjor të anketuesve dhe gjithë punonjësve të përfshirë në Cens, për të nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit, përmes së cilës ata bien dakord të mos zbulojnë, informacionin e mbledhur në çdo kohë gjatë punës ose pas saj, dhe përdorimin e teknikave të ndryshme për të shmangur zbulimin e të dhënave.

Kujdes i veçantë iu kushtua mbledhjes dhe ruajtjes së informacionit për karakteristikat etno-kulturore. Pyetjet e Censit për përkatësinë etnike, fenë dhe gjuhën ishin, me ligj, të bazuara në të drejtën për vetidentifikim, duke lejuar si një përgjigje të vlefshme alternativën “Preferoj të mos përgjigjem”. Kategoritë e përgjigjeve për këto pyetje u renditën në mënyrë të rastësishme sa herë që një pyetje shfaqej në tablet për të reduktuar paragjykimet e përgjigjeve dhe secila pyetje përfshinte opsionin për të specifikuar çdo përgjigje tjetër përveç opsioneve të paracaktuara. Për secilën nga tre pyetjet, i anketuari kishte mundësinë të konfirmonte përgjigjen siç tregohet në tablet. Pas konfirmimit, përgjigjet u “ngrinë” dhe u ruajtën veçmas, pa mundësi për të bërë ndryshime në një fazë të mëvonshme. Një komponent kritik i infrastrukturës së TI për Censin ishte integrimi i masave të avancuara të sigurisë për të siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin. Zgjidhjet u krijuan me protokolle të rrepta sigurie për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm nga akses i paautorizuar dhe shkeljet e mundshme. Të dhënat e mbledhura në tableta u koduan për të siguruar që informacionet personale të mbeten të sigurta gjatë mbledhjes dhe ruajtjes. Në mënyrë të ngjashme, të dhënat e transmetuara në serverët qendrorë u koduan gjatë transferimit, duke siguruar një shtresë shtesë mbrojtjeje. Vetë serverët e Censit ishin të mbrojtur me masa të forta sigurie, duke përfshirë firewall dhe sistemet e zbulimit të ndërhyrjeve, për të parandaluar dhe zbutur sulmet kibernetike. Veçanërisht, këto mbrojtje siguruan që të dhënat e Censit të mbeten të pakompromentuar, edhe gjatë sulmit kibernetik të Janarit 2024 ndaj INSTAT. Sinkronizimi ditor shërbeu gjithashtu si një masë thelbësore sigurie

frequently-asked-questions (FAQs), were disseminated, most of which included the key Census messages: “Me, You, US” and “Hold the future in your hands!”

In view of the challenge to recruit thousands of temporary Census staff for the enumeration work, an important part of the communication campaign was dedicated to raise awareness of the job opportunities in the Census operation.

1.9 Data confidentiality and security

The Laws on Official Statistics, on Census of Population and Housing and on Protection of Personal Data defined the rules for confidentiality and data protection in the Census. The laws stipulate that the data collected by the Census shall be used only for statistical purposes, in accordance with the standards and recommendations of Eurostat and the UNECE. The collection and processing of personal data is conducted while respecting and guaranteeing basic human rights and freedoms, particularly the right to privacy. According to these laws, disseminated Census results cannot be attributed to individual persons and will not contain personal identifiers or information that could lead to the identification of individuals. Data confidentiality is not only required in the dissemination of Census results, but throughout the entire Census operation: from the initial data collection to data transfer, data processing, analysis, tabulation, dissemination and storage. INSTAT implemented a comprehensive set of rules and procedures to ensure that at no stage is data confidentiality violated and that the data are at all times protected against access by any unauthorised persons. These included, among other things, thorough training of Census staff on the importance of confidentiality and data protection, the legal obligation of enumerators and other Census staff to sign the confidentiality agreement through which they agree not to disclose, without authority, the information collected at any time during the work or afterward, and the use of different techniques to avoid data disclosure. Special care was given to the collection and preservation of information on ethno-cultural characteristics. The Census questions on ethnicity, religion and language were, by law, based on the right to self-identification, allowing ‘Prefer not to answer’ as a valid response. Response categories for these questions were randomly ordered each time a question

kundër humbjes së të dhënave, duke lejuar që të dhënat të ruhen rregullisht në serverët qendrorë. Kjo siguroi që të dhënat personale të të anketuarve të trajtoheshin me konfidencialitetin maksimal, duke iu përmbajtur standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave.

appeared on the tablet to reduce response bias and each question included the option to specify any answer other than the pre-defined options. For each of the three questions, the respondent had the possibility to confirm the answer as shown on the tablet. Upon confirmation, the answers were fixed and separately stored, without the possibility to make changes at a later stage. A critical component of the IT infrastructure for the Census was the integration of advanced security measures to safeguard data protection and confidentiality. The solutions were designed with stringent security protocols to protect sensitive information from unauthorised access and potential breaches. Data collected on tablets were encrypted to ensure that personal information remained secure during collection and storage. Similarly, data transmitted to the central servers were encrypted during transit, providing an additional layer of protection. The Census servers themselves were fortified with robust security measures, including firewalls and intrusion detection systems, to prevent and mitigate cyber-attacks. Notably, these protections ensured that the Census data remained uncompromised, even during the January 2024 cyber-attack on INSTAT. Daily synchronisation also served as a crucial security measure against data loss, allowing data to be regularly backed up to central servers. This ensured that the personal data of respondents were handled with the utmost confidentiality, adhering to national and international standards for data protection.

ANEKSI I: MODULET DHE TEMAT E PYETËSORIT PËR NJËSITË EKONOMIKE FAMILJARE

Identifikimi i ndërtesës – Moduli për identifikimin e ndërtesave dhe njësive të Censit në ndërtesa:

- Identifikimi gjeografik dhe kodi i ndërtesës
- Statusi i ndërtimit të ndërtesës
- Statusi i banimit të ndërtesës
- Përdorimi i ndërtesave jo për qëllime banimi
- Lloji i banesës kolektive
- Prania e banorëve të zakonshëm në ambientet e banesës kolektive

Identifikimi i banesës – Moduli për identifikimin e banesave në ndërtesa:

- Numri i katit dhe i banesës

Fillimi i numërimit – Moduli me procedurat për fillimin e numërimit të një njësie ekonomike familjare apo banese:

- Koordinatat GPS të banesës
- Identifikimi i banesave boshe
- Qëllimi i banesës
- Lloji i banesës kolektive
- Arsyeja e mosfillimit të intervistës

ANNEX I: PRIVATE HOUSEHOLD QUESTIONNAIRE MODULES AND TOPICS

Building identification – Module to identify buildings and Census units in buildings:

- Geographic identification and building code
- Construction status of the building
- Residential status of the building
- Use of non-residential buildings
- Type of collective living quarters
- Presence of usual residents in collective living quarters

Dwelling identification – Module to identify dwellings in buildings:

- Floor and dwelling number

Enumeration start – Module with procedures to start enumeration of a household or dwelling:

- Dwelling GPS coordinates
- Identification of vacant dwellings
- Purpose of the dwelling
- Type of collective living quarters
- Reason not starting enumeration interview

Informacioni mbi ndërtesën – Moduli për të identifikuar karakteristikat e ndërtimit:

- Lloji i ndërtesës
- Viti/periudha e ndërtimit

Informacioni mbi banesën – Moduli për të identifikuar karakteristikat e banesës:

- Lloji i banesës
- Pronësia e banesës
- Statusi i banimit
- Adresa e banesës
- Sistemi i furnizimit me ujë
- Lloji i tualetit
- Dush ose vaskë
- Furnizimi me energji elektrike
- Sistemi i ngrohjes
- Energjia për ngrohje
- Sipërfaqja e përdorshme
- Numri i NjEF në banesë

Building information – Module to identify building characteristics:

- Type of building
- Year/period of construction of the building

Dwelling information – Module to identify characteristics of the dwelling:

- Type of dwelling
- Ownership of dwelling
- Occupancy status of dwelling
- Address of dwelling
- Water supply system
- Toilet facility
- Bathing facility
- Electricity supply
- Heating system
- Energy for heating
- Useful floor space
- Number of households in the dwelling

Informacioni mbi NjEF – Moduli për të identifikuar karakteristikat e NjEF:

- Statusi i pronësisë
- Pajisjet e NjEF

Moduli i ish anëtarëve të NjEF – Modul për mbledhjen e informacionit për anëtarët e mëparshëm të NjEF, të cilët jetojnë jashtë vendit:

- Emri dhe mbiemri
- Gjinia
- Data e lindjes
- Shtetësia
- Shteti i vendbanimit të zakonshëm
- Viti i emigrimit
- Arsyeja e emigrimit

Moduli i vizitorëve – Modul për mbledhjen e informacionit për individët përko-hësisht prezentë në banesë, për të minimizuar individët që nuk janë kontaktuar në vendbanimin e tyre të zakonshëm:

- Emri dhe mbiemri
- Gjinia
- Data e lindjes

Household information – Module to identify characteristics of the household:

- Tenure status
- Presence of household amenities

Former household member module – Module to collect information about former household members living abroad:

- Name and surname
- Sex
- Date of birth
- Country of citizenship
- Country of usual residence
- Year of emigration
- Reason for emigration

Visitor module – Module to collect information temporary present persons in the dwelling to mitigate persons not contacted at their place of usual residence:

- Name and surname
- Sex
- Date of birth

- Informacion identifikimi (numri i ID, emri i babait dhe nënës)
- Vendbanimi i zakonshëm

Informacioni mbi bujqësinë – Moduli për identifikimin e njësive ekonomike bujqësore:

- Lloji dhe madhësia e tokës së kultivuar nga NjEF
- Lloji dhe numri i bagëtive dhe/ose shpendëve të mbarështuara nga NjEF
- Numri i koshereve të bletëve, mbajtur nga NjEF

Lista e NjEF – Moduli për të identifikuar anëtarët e zakonshëm të NjEF dhe karakteristikat e tyre identifikuese:

- Emri dhe mbiemri
- Gjinia
- Lidhja me personin e referencës të NjEF
- Data e lindjes
- Mosha
- Statusi ligjor martesor

Moduli individual – Modul për të mbledhur informacion rreth anëtarëve të zakonshëm të NjEF:

- Statusi në bashkëjetesë
- Identifikimi i anëtarëve të familjes në NjEF (bashkëshorti/ja, babai, nëna)

- Identification information (ID number, name of father and mother)
- Place of usual residence

Agricultural information – Module to identify agricultural holdings:

- Type and size of land cultivated by the household
- Type and number of livestock raised by the household
- Number of beehives kept by the household

Household list – Module to identify usual household members and their identification characteristics:

- Name and surname
- Sex
- Relation to the household reference person
- Date of birth
- Age
- Legal marital status

Individual module – Module to collect details about usual household members:

- Cohabitation status
- Identification of family members in the household (spouse, father, mother)

- | | |
|---|---|
| • Vendlindja | • Place of birth |
| • Shtetësia | • Country of citizenship |
| • Vendbanimi i zakonshëm në vitin 2011 | • Place of usual residence in 2011 |
| • Vendbanimi i zakonshëm i mëparshëm | • Previous place of usual residence |
| • Koha e mbërritjes në Njësinë Administrative/ Shqipëri | • Time of arrival in administrative unit / Albania |
| • Arsyeja e migrimit të brendshëm/ndërkombëtar | • Reason for internal / international migration |
| • Aftësitë e shkrimit dhe leximit | • Literacy |
| • Ndjekja e çerdhes dhe kopshtit | • Attendance in nursery school and kindergarten |
| • Ndjekja e arsimit dhe niveli arsimor që ndjek | • Current school attendance and level of attendance |
| • Niveli arsimor i përfunduar | • Level of educational attainment |
| • Puna në bujqësi | • Engagement in subsistence agriculture |
| • Punësimi | • Labour force status |
| • Arsyeja për të mos punuar | • Reason for not working |
| • Statusi i punësimit | • Status in employment |
| • Orët e punës në periudhën referencë | • Hours worked in the reference period |
| • Profesioni | • Occupation |
| • Industria | • Industry |

- Vendi i punës
- Shpeshtësia e udhëtimit për në punë
- Mjetet e transportit për në punë
- Kohëzgjatja e udhëtimit për në punë
- Informacion mbi fëmijët e lindur gjallë
- Identiteti etnik
- Besimi fetar
- Gjuha që zakonisht flitet në shtëpi
- Vështirësi funksionale (në shikim, në dëgjim, në ecje ose ngjitje shkallësh, për të mbajtur mend/ përqendrim/mësuar, në kujdesin e përditshëm ndaj vetes, në komunikim)
- Numri i ID

- Place of work
- Frequency of travel to work
- Means of transport to work
- Time of travel to work
- Information on live-born children
- Ethnicity
- Religion
- Language usually spoken at home
- Functional difficulties (seeing, hearing, walking or climbing stairs, cognition, daily self-care, communication)
- ID number

ANEKSI II: KONCEPTE DHE PËRKUFIZIMET KRYESORE TË CENSIT

Aftësia e kufizuar: Çdo kufizim që një individ ka në kryerjen e aktiviteteve funksionale, të tilla si shikimi, dëgjimi, ecja ose ngjitja e shkallëve, njohja, vetkujdesi i përditshëm dhe komunikimi, edhe nëse kufizime të tilla përmirësohen nga përdorimi i pajisjeve ndihmëse.

Aftësitë e shkrimit dhe leximit: Aftësia për të shkruar dhe lexuar një tekst të shkurtër mbi jetën e përditshme të vetë individit.

Analfabet: Një individ i cili, nuk mund të lexojë dhe të shkruajë një tekst të shkurtër, mbi jetën e tij të përditshme.

Anëtar i mëparshëm i NjEF: Një individ që në të kaluarën ishte anëtar i NjEF, e cila do të numërohet, por në periudhën ndërmjet Cens 2011 - Cens 2023 është zhvendosur si vendbanues i zakonshëm në një vend tjetër.

Anketuesi: Punonjësi i Censit në terren, përgjegjës për numërimin e banesave, NjEF dhe individëve në ZC të caktuar për ta.

Banasa: Një njësi e veçantë dhe e pavarur banimi, ose e destinuar për banim nga NjEF, pavarësisht nëse banasa është apo jo e banuar në momentin e Censit, ose jo e destinuar për banim, por përdoret si vendbanim në momentin e Censit.

Banesat kolektive: Ambiente të krijuara për qëllime banimi të përbashkët nga grupe të mëdha individësh ose disa NjEF dhe që përdoren si vendbanim i zakonshëm i të paktën një individ në momentin e Censit. Në to strehohen grupe individësh të cilët, megjithëse nuk bashkohen domosdoshmërisht nga marrëdhëniet e martesës, gjakut, birësimi ose përkrahjes, jetojnë së bashku për qëllime shkollimi, shëndetësore, vuajtje dënimi, mirëqenieje ose arsye të tjera.

Bërthama Familjare: Dy ose më shumë individ që jetojnë në të njëjtën NjEF dhe që janë të lidhur në martesë ose në bashkjetesë të dakortësuar ose si prind dhe fëmijë.

ANNEX II: MAIN CENSUS CONCEPTS AND DEFINITIONS

Disability: Any limitation that a person experiences in performing functional activities, such as seeing, hearing, walking or climbing stairs, cognition, daily selfcare, and communication, even if such limitations are ameliorated by the use of assistive devices.

Literacy: The ability to both read and write a short statement on the person's everyday life.

Illiterate person: A person who cannot both read and write a statement on his or her everyday life.

Former household member: A person who in the past was a member of the household being enumerated, but who within the previous ten years has moved to another country to take up usual residence there.

Enumerators: The Census field staff responsible for enumerating the dwellings, households and persons in the EA assigned to them.

Building: Any independent structure containing one or more dwellings, rooms or other spaces, covered by a roof and enclosed within external walls or dividing walls that extend from the foundations to the roof, whether designed for residential or for agricultural, commercial, industrial or cultural purposes or for the provision of services.

Collective living quarters: The premises that are designed for habitation by large groups of individuals or several households and that are used as the usual residence of at least one person at the time of the Census. They house groups of people who, although usually not united by relations of marriage, blood, adoption or fostering, live together for purposes of schooling, health, detention, welfare or other reasons.

Censi: Numërimi i plotë i të gjithë individëve, NjEF (njësive ekonomike familjare) dhe banesave brenda territorit të një vendi, në një moment të vetëm në kohë dhe duke siguruar një panoramë të karakteristikave demografike, ekonomike dhe sociale në vend.

Cens de-jure: Censi numëron individët në vendin e tyre të vendbanimit të zakonshëm, pavarësisht nëse janë ose jo prezent atje në momentin e Censit. Një Cens de-facto nënkupton numërimin e individëve në vendin ku ata ishin prezent në momentin e Censit, pavarësisht vendbanimit të tyre të zakonshëm në atë moment.

Dita e Censit: Dita pas natës së Censit, që nënkupton ditën e parë të periudhës së numërimit të Censit. Në Censin e Popullsisë dhe Banesave të vitit 2023, dita e Censit ishte dita e hënë, më 18 Shtator 2023.

Kontrollori: Punonjësi i Censit në terren, përgjegjës për mbikëqyrjen, monitorimin dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë e punës së numërimit të zakonisht 5 anketuesve.

